Interreg

Co-funded by the European Union

IPA Greece – Albania

AGRI Adapt

Water Resource Intelligence for Climate Adaptation and Agricultural Resilience

(Inteligjenca e Burimeve Ujore për Përshtatjen ndaj Klimës dhe Rezistencën Bujqësore)

AGRI Adapt

Bashkia Maliq është partnere në projektin **AGRI Adapt**, i zbatuar në kuadër të Interreg VI-A IPA Cross-Border Cooperation Programme Greece–Albania dhe bashkëfinancuar nga European Union.

Projekti synon të përmirësojë menaxhimin e burimeve ujore dhe të rrisë qëndrueshmërinë e bujqësisë përballë ndryshimeve klimatike në zonën ndërkufitare Greqi–Shqipëri.

Përmes një rrjeti monitorimi hidrologjik dhe një Sistemi Mbështetës Vendimmarrjeje (DSS), **AGRI Adapt** ofron udhëzime për ujitje në kohë reale, duke reduktuar humbjet e ujit dhe duke forcuar sigurinë ushqimore.

Një hap konkret drejt bujqësisë inteligjente dhe rezistente ndaj klimës.

Informacione më të detajuara mund të gjeni në linkun e mëposhtëm:

https://greece-albania.eu/project/agri-adapt/

Interreg Europe

Co-funded by the European Union

NATUREFIN

Projekti NATUREFIN shërben për të përmirësuar instrumentet e politikave që kanë rëndësi për vlerësimin dhe shqyrtimin e zhvillimit rajonal me rreziqet që lidhen me natyrën.
Projekti ka në fokus:
-Përmirësimin e natyrës dhe biodiversitetit.
-Planifikon një proces mësimor për të ndërtuar kapacitete, ndarjen e përvojave dhe praktikave të mira të autoriteteve midis shteteve pjesmarrëse.
Gjithmonë duke u mbështetur në rregulloret e BE-së për financimin e qëndrueshëm NATUREFIN do të ndihmojë rajonet të hartojnë politika që mbështesin më mirë zhvillimin pozitiv ndaj natyrës. Duke aplikuar mjete të financimit të qëndrueshëm, partnerët do të jenë në gjendje të drejtojnë investimet drejt aktiviteteve që mbrojnë biodiversitetin, rivendosin ekosistemet dhe përmirësojnë qëndrueshmërinë mjedisore afatgjatë.
Projekti rrit mirëqenien përmes politikave që ruajnë asetet natyrore, krijojnë hapësira më të gjelbra dhe inkurajojnë zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Komunitetet përfitojnë nga cilësia e përmirësuar e mjedisit dhe ekonomitë rajonale më elastike.
Konkretisht në Bashkinë Maliq do të përqendrohemi tek:

- Zbutja e ndotjes së ajrit dhe ujit
- Menaxhimi i zonave të nxehta të peizazhit dhe mjedisit
- Zgjerimi dhe parashikimi i hapësirave të gjelbra
- Përdorimi i qëndrueshëm i tokës dhe modernizimi i infrastrukturës
- Mekanizmat e monitorimit dhe zbatimit
- Stimujt për praktikat miqësore me mjedisin
- Të dhënat dhe vendimmarrja transparente mjedisore

Më shumë të dhëna mund të gjeni pranë faqes së projektit

https://www.interregeurope.eu/naturefin